



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Mirembajtje e sistemit te linjave elektrike dhe kabinave te stacioneve

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

transformator tensioni 31172000-2

Shërbime të ndryshme të biznesit 79990000-0

VLERA E FONDIT LIMIT: 5 800 000 (pese milion e teteqind mije) leke pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Shoqeria Rajonale **Ujësjetlës Kanalizime sha Pogradec** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës shtojca 3;*
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1.Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Operatori duhet të ketë të përfshirë në objektin e veprimtarisë në Ekstraktin e QKB edhe objektin e prokurimit të kësaj kontrate.

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe shtojcës 8 të DST-së.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet 2020,2021 dhe 2022, ku vlera e përlogaritur nuk mund të tejkalojë 40% e fondit limit të këtij prokurimi.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: “ Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

.... 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar”. Kjo procedurë është nën kufirin e ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara....

Si dhe neni 55/4.....” Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.”

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse vlera e xhiros minimale për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, është jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet. Në çdo rast, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2.2 Pasqyrat financiare për vitet (2020,2021,2022) të konfirmuara nga administrata tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilanci duhet të shoqërohet edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.

Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mos shlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Pika e)

Furnizime të mëparshme të ngjashme me një vlerë jo më të madhe se 20% të fondit limit të objektit të prokurimit, të realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, vërtetuar me dokumentacionin vërtetues si më poshtë:

- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi,

- dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 dhe neni 55 pika 4 gërma b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikate të vlefshme që verteton se sistemi i kontrollit dhe menaxhimit të cilësisë së tij është në përputhje me ISO 9001 - 2015 dhe objekti i saj të përputhet me mallrat e kërkuara.

Argumentimi: Në lidhje me kërkesën që OE ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatën e standarteve ISO, është menduar se ky është një kriter i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës si dhe në propozicion me të, me qëllim garantimin e realizimit në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standarteve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

Certifikata për sistemin e menaxhimit të cilësisë ISO 9001 është e nevojshme si kriter kualifikues pasi lidhet me natyrën dhe vlerën e kontratës, me qëllim për të vertetuar dhe të garantojë realizimin në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standarteve ndërkombëtare të objektit të kontratës. Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 44, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, dhe nenin 79 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikate ISO 14001-2015 e përditësuar “Për sistemin e menaxhimit të mjedisit”, (ose ekuivalent) objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.

Argumentimi: Ky kriter është kërkuar pasi angazhimi për mbrojtjen e mjedisit kthehet në një kriter madhor në zgjedhjen e një prodhuesi kurse metoda me e thjeshtë dhe me efikasë për të shfaqur kujdes ndaj problemeve lidhur me mjedisin është zbatimi i një sistemi menaxhimi për mjedisin në konformitet me standardin ndërkombëtar ISO 14001.

Operatori Ekonomik duhet te paraqese Certificate ISO 45001:2018 e perditesuar(ose ekuivalent) per sistemin e menaxhimit e sigurise dhe shendetit ne pune.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”,si dhe në zbatim tëNeni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,e ndryshuar ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

Ky kriter eshte kerkuar per te mbajtur vendin e punes sa më të shëndetshëm dhe sa të sigurt për të punësuarit ashtu siç përcaktohet me ligj. Sistemi për menaxhimin e sigurisë dhe shëndetit në punë OHSAS 18001 që është një standard ndërkombëtar .marrjen e masave ndaj reziqeve qe mund te shkaktohen gjate punes.

Për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore, profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike të projektit, operatori ekonomik duhet të ketë te punesuar te pakten 10 punonjes ku te perfshihet edhe minimalisht 1 inxhinier elektrik te pajisur me Diplome. Plotesimi i ketij kriteri duhet te vertetohet me paraqitjen e formulareve E-SIG per periudhen e 3 muajve te fundit duke iu referuar dates se hapjes se ofertave.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Qe te sigurohet puna qe do te kryhet , zgjidhja e incidenteve dhe problemeve, zgjerimi i funksionaliteve, etj, kerkohet qe OE duhet te kete ne stafin e propozuar te pakten personel me njohuri/aftesi te nevojshme te certifikuara nga prodhuesi i teknologjive te sistemit. Duke nisur nga vete natyra e punes qe do te kryhet inxhinieri elektik eshte I domosdoshem. Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar,që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve dhe qenia e tyre ne listepagesa, tregon besueshmëri për autoritetin. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Operatori ekonomik duhet te paraqese flete garancine per nje vit per mallrat qe ofron :

1. Trasformator me vaj me dy tensione 250KVA20\100.4KV
2. Trasformator me vaj me 50KVA10\0.4KV
3. UPS 15 KVA + dy blloqe me bateri
4. Automat 3 Fazor 3 Polar 400A
5. PLC Moeller easy 819-DC-RCX 10 240V AC B300
6. Sensorit te nivelit te presionit te Ajrit ne Impiant
7. Sensorit te nivelit te presionit hidrulik ne Impiant
8. Sensorit te nivelit te numrit te rrotullimeve ne Impiant
9. Sensorit prestostat ne Impiant
10. Sensorit fotoelement ne Impiant
11. Bateri 12V 1300m Ah
12. Ushqyes per baterine 12 V/100 LA 15 230AC
13. Elektroventil
14. Sensor induktiv nf 500a m12, 7.3-30 vdc

Argumentimi: Nepermjet ketij dokumenti zyrtar operatori ekonomik fitues garanton per nje periudhe 1 vjecare autoritetin kontasktor , per marjen persiper te te gjitha difekteve dhe problemeve qe mund tu ndohin mallrave .

Operatori ekonomik duhet te disponoje makinerite/pajisjet e meposhtme:

- Mjet ngrites (pirun) deri 2.5 ton.
- Pajisje saldimi per hekur, baker dhe alumin;
- Tranxhe metalike;
- Trapano kolone ;
- Vinc elektrik 2.5 ton i montuar ne ambjentin e OE .
- Paisje per testimin me tension te aplikuar deri ne 1000 kVA
- Paisje per testimin me tension te induktuar dyfish (2Un) dhe frekuence dyfishe (100 Hz).

Operatori ekonomik duhet te vertetoje pronesine e makinerive/pajisjeve te mesiperme nepermjet faturave tatimore te blerjes, kontrate blerje, kontrate dhurimi apo cdo forme tjeter e fitimit te pronesise sipas kodit civil, ose nepermjet deklarates noteriale te shoqeruar me fotografite e makinerive/pajisjeve, ose nepermjet kontrates se qirase per makinerite/pajisjet e marra me qera, e cila duhet te shoqerohet me aktin e pronesise mbi makinerite/pajisjet qe merren me qera

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion

operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Numri i fuqisë punëtore i kërkuar, mjetet dhe pajisjet e kërkuara janë vendosur në raport me zërat dhe volumet e punimeve, grafikun e punimeve si dhe afatin e parashikuar për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

Numri dhe lloji i pajisjeve në pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i'u referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut,

kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekteve. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët.

Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e

kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

Ne funksion të plotesimit të Shtojcës 8 “Formulari përmbledhës i vetedeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet të japë të dhëna të qarta si Emer, Mbiemer, Atesi, Amesi, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje të skanuar të dokumentit të identifikimit (shqiptar ose të huaj), për Administratorin / Administratoret e shoqërisë, Ortakun/Ortakët e shoqërisë, përfaqësues të ndryshëm të posaçëm të shoqërisë, drejtues të ndryshëm të shoqërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe shtojcës 8 të DST-së.

Komisioni

Ilir Vako	(Inxhinier, specialist fushe)
Edmond Jakupllari	(elektricitist)
Arben Kasemllari	(përgjegjës I stacionit të pompimit të ujrave të përdorura)